

KPA largon nga sistemi i drejtësisë gjyqtarin e Apelit Shkodër, Luan Dervishi



Kolegji i Posaçëm i Apelit rrëzoi ankesën e ish gjyqtarit të Apelit Shkodër Luan Dervishi, duke lënë në fuqi vendimin e shkarkimit.

Vendimi u mor nga trupa gjykuese e përbërë nga Ardian Hajdari, Sokol Çomo, Albana Shtylla, Ina Rama dhe Natasha Mula.

Luan Dervishi u shkarkua nga detyra më 26 nëntor 2018, pasi ju gjetën probleme të shumta në deklaratimet e pasurive dhe mungesë profesionalizmi. KPK argumentoi se gjyqtari Dervishi kishte deklaratime të pasakta; fshehje e pasurive dhe mungesë e burimeve të ligjshme për justifikimin e tyre; deklaratime të rreme e konflikt interesi.